

E SHTUNA E SHPIRTEVE

Në Shërbesën e Mëngjazit, pas të Gjashtë Psalmeve këndohet dy herë pa vargje dhe dy herë me vargje në T. T. IV:

Alilluia, alilluia, alilluia.

Alilluia, alilluia, alilluia.

Lum ata që ke zgjedhur, dhe ke marrë pranë teje o Zot.

Alilluia, alilluia, alilluia.

Shpirtet e tyre do të banojnë me të drejtët.

Alilluia, alilluia, alilluia.

Pastaj këndohen Troparet:

PERLESHORJA E SHPIRTEVE, T.T. IV.

Ti që i regullon të gjitha me njeridashje dhe urtësi, dhe u dhuron të gjithëve pas interesit i vetëm Krijetar, preh-i shpirtet e shërbëtorëve të tu o Zot, se më ty e kemi tërë shpresën, o bërës dhe gatonjës dhe Perëndia ynë.

LAVDI. Se më ty e kemi tërë shpresën, o bërës dhe gatonjës dhe Perëndia ynë.

TANI. Ty të kemi, si fortesë dhe liman, nërmjetëse ndihmëse, pranë Birit Jesu Krisht, Virgjëreshë Hyjlin-dëse, dhe shpëtim i besnikëve.

Pastaj këndohen Psalmet e Prëhjes në tri Stanza, Bekim-toret Funerale, Litania e Prëhjes, Shkurtorja, dhe Shtëpia e Prëhjes. (Shiko Uratoren, f. 439-442).

SINAKSARI

Gjithë sot kujtojmë të gjithë ata, që kanë fjetur me besë që prej jetëve me shpresën e ngjalljes për jetën e ameshuar.

O Zoti Jesu Krisht, vëndos-i shpirtet e atyre, që janë prëhur përpara nesh, në tendat e të Drejtëve, dhe mëshirona si i vetëm i pavdekur. Amin.

ZBRITESORET, T. T. IV.

ASMA ANAPEMPSOMEN

I. Eni t'i blatojmë besërisht, Perëndisë lavdërim, i cili e shpëtoj prej robërisë Israelin, dhe le t'i këndojmë këngë mundëse me thirrje: Zot i vetëm, ti je i bekuar.

II. Shihni që unë jam, i vërtet' i vetëm Zot dhe Perëndi, Bir i Atit që kam lindur lart në qell, dhe jam mishëruar prej Marisë, Virgjëreshës përmi dhe, dhe mëkatin e Adamit, e kam larë nga që jam, mik i njerësve.

III. O shiguronjës i tërë botës, o Fjal' e Zotit Perëndi, dritë na dhuro, të të njohim dhe të lutemi, mprona dhe na shiguro, se vetëm ty të ka besim çdo zëmër.

IV. Prej Nënës Virgjëreshë, malit hieplotë, e mori vesh Profeti, se po mishërohesh, ti o Fjal' e Perëndisë, dhe me frikë, të lavdërojmë ty o Zot i Math.

V. Me natë vjen shpirti im, pas teje o Zot, dhe porrosive të ndriçime, që na ke dhënë ti; me ato pra ndriçonaje ndërgjegjen o Zot i Math, edhe ti na prir, për jet' e për qjell.

VI. Të përmbledhur më prit o mik i njerësve, se përgjunjem përdhe, dhe lyp prej teje ndjesë fajesh, posi Profeti dhe shpëto-më ti o Zot.

VII. Ti o Zot që themelove dhënë, dhe shigurove qjellin me fjalë, o Perëndi i Atërve i bekuar je, përherë dhe për jetë.

VIII. Zotin tonë të çfaqur lart, në malin dhe në ferrën, me zjarr të Nënës Virgjëreshë, sikundër ia tregoj Profetit Moisi, eni e hymnoni, dhe e lartësoni përherë dhe për jetë.

IX. Lindjen e treguar me çudi për Moisinë, lart në mal me ferrën, prej Hyjlindëses Virgjëreshë, për shpëtim dhe ndjesë prej mëkatash, le ta madhësojmë pa pushim.

DERGIMESORET, T. III

PAS EPESKEPSATO IMAS

Zot i Math që mbretëron, mi botën e të gjallëve, dhe varret e të vdekurve, dhuroju paqen shpirtëve, në tendat e të drejtëve, në dritën e Parajsës, në mes të Shenjtorëve.

Preh-i shpirtet lart në qjell, në vëndin e të gjallëve, n' atë vënt ku nukë ka, dhëmbje helm e psherëtim, të gjitha fajet ua fal, i vetëm njeridashës, dhe Mbret i mëshirave.

O Zonjë dhe Hyjlindëse, përpara Krishtit nërmjeto, për ndjesën e mëkatave, dhe prëhjen e besnikëve, në tendat e të drejtëve, në dritën e Parajsës, në mes të Shenjtorëve.

LAVDERIMET, T. II
PAS IKOS TU EFRATHA

Eni shikojeni, që jemi hi dhe pluhër, se iku bukuria, dhe mbetnë vetëm eshtrat, në varret e të vdekurve.

Mos u-gënjeni pra, më kot mos u-mërzitni, po rentni pranë Krishtit, kërkoni tju dhuronjë, Parajsën e Shenjtorëve.

Preh-i o Shpëtimtar, besnikët e përunjur, që kanë ndruar jetën, me shpresën e patundur, të ngjalljes së lavdishime.

Krishhti u-ngjall për ne, gëzohuni besnikë, se do tju ngjallë prapë, dhe do tju falë jetën, Parajsën e Shenjtorëve.

LAVDI, T. II. Si lule fishken, dhe si ëndërra shkojnë, dhe shuhen gjithë njerëzit. Po kur të gjëmonjë trumbeta, të gjithë të vdekurit do të ngrihen prapë, dhe do të dalin të të presin o Krisht. Ahere vëndos-i shpirtet e besnikëve, në tendat e Shenjtorëve.

TANI. Gëzohu Mari Virgjëreshë, dhe Zonjë Hyjlindëse, tempull i Perëndisë, nërmjeto pranë Birit tënt, për prëhjen e besnikëve.

Doksollogji e Madhe. Në Hyrjen këndohen këto Tropare:

PERLESHORJA E SHPIRTEVE, T. T. IV

Ti që i regullon të gjitha me mirëdashje dhe urtësi, dhe u dhuron të gjithëve pas interesit i vetëm Krijetar, prëh-i shpirtet e shërbëtorëve të tu o Zot, se më ty e kemi tërë shpresën, o bërës dhe gatonjës dhe Perëndia ynë.

Pastaj Përlëshorja e Shenjtit të Kishës, Shkurtorja e Prëhjes, Apostulli dhe Ungjilli i Varrimit.

KUNGATORJA, T. T. IV

Lum' ata që i ke zgjedhur, dhe i ke marrë pranë teje, o Zot. Kujtimi i tyre do të jetë bres pas brezi.

Pas Meshës këndohet Shërbesa e Përshpirtit të Vogël (shiko Uratoren, f. 460-462.)